



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:084620

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05460321

KPPP.nr.237/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit Raiffeisen Leasing Kosovo L.L.C, me NUI:811282459, me seli në Prishtinë, Rr. "UCK" nr. 222, kundër debitorit "Selmans Network" SH.P.K, me NUI:810815061, me seli në Prishtinë, Rr. "Jakov Xoxa" Kompleksi Blini, pn, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit të Përbaruesit Privat Valdrin Beka, me seli të zyrës në Prishtinë, P.nr.56/23 të dt:26.01.2023, jashtë seancës me datë 15.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET I TËRHEQUR prapësimi i debitorit të përbarimit "Selmans Network" SH.P.K, me NUI:810815061, me seli në Prishtinë, Rr. "Jakov Xoxa" Kompleksi Blini, pn, i datës 03.02.2023, sipas parashtrës-deklaratës së dhënë me shkrim pranë kësaj gjykate të datës 23.02.2023.
- II. Lënda KPPP.nr.237/2023, të kthehet tek organi përbarimor/Përbaruesi Privat Valdrin Beka, me seli të zyrës në Prishtinë.

A r s y e t i m

Organi përbarues, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit ka lëshuar urdhër me numër P.nr.56/23 të dt:26.01.2023, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor - Kontratës për Lizingun Financiar me numër LRP.nr.6694/19, Ref 2055/19 të

datës 25.04.2019, e cila kontratë paraqet titull ekzekutiv në bazë të nenit 21, 22 par. 1 pika 1.3 të LPP-së, duke caktuar përmbarim të drejtpërdrejtë apo/edhe duke urdhëruar organin e rendit (Policia e Republikës së Kosovës) për këtë qëllim, ndërsa aset-lokali afarist ti dorëzohet në riposedim kreditorit për ta shitur me çmimin që ai e konsideron të arsyeshëm, dhe nga çmimi i shitblerjes të përmbushet obligimi i debitorit në shumë totale prej 104,441.67€, si dhe kamata e rregullt e kontraktuar deri në ditën e pagesës së bashku me kamatëvonesën, dhe të gjitha shpenzimet tjera, sikurse të gjitha taksat e përmbaruesit sipas legjislacionit në fuqi, riposedim, riparim, në rast të dëmit, ruajtje të të njëjtit, si dhe shpenzimet e organizimit të shitjes.

Debitori “Selmans Network” SH.P.K, me datën 22.02.2023 pranë Zyrës Përmbarimore VAIS Law ka paraqitur parashtresën me titull “Parashtresë për tërheqjen e Prapësimit”, e cila në Gjykatën Komerciale të Kosovës është regjistruar-pranuar me datën 23.02.2023, duke deklaruar se “Në cilësi të debitorit në këtë çështje përmbarimore e tërheqim prapësimin e ushtruar kundër urdhrit për përmbarim P.nr.56/23 të datës 26.01.2023”.

Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet e lartcekura, gjegjësisht parashtresën e palës debitore, në pajtim me nenin 17 të LPP-së lidhur me nenin 3 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko-civile që i kanë para-shtruar gjatë procedurës.”*, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, duke e konstatuar të tërhequr prapësimin e debitorit - konform dispozitës nga neni 261 par. 3 dhe 4 të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,**

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 237/2023, datë 15.03.2024

Gjyqtari,

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar Ankesa.